

NJOFTIM

SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT NJOFTON PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK PËR SHITJE SKRAP HEKURI

Në mbështetje të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, si dhe vendimit nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndryshuar, njoftojmë sa më poshtë:

- Fillimin e procedurës së hapur të ankandit për shitje skrap hekuri, të përfituar nga nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve të transportit dhe pjesëve të këmbimit, më datë 09.12.2013.
- Vlera e përgjithshme fillestare e ankandit 1 779 516 (njëmillioneshtatëqindeshtatëdhjetëenëntëmijëepesëqindëgjashtëmbëdhjetë) lekë.
- Seti i dokumentave të ankandit do të jetë në dispozicion për çdo ofertues, në faqen zyrtare të internetit të Shërbimit Informativ të Shtetit, ndërsa mund të tërhiqet pranë SHISH çdo ditë nga ora 8:00 deri ne 11:00, kundrejt pagesës prej 500 lekësh, brenda afatit të fundit të pranimit të ofertave.
- Njoftimi do të qëndrojë i publikuar për një periudhë 20 ditore kohë gjatë së cilës çdo i interesuar mund të paraqesë me shkrim ofertën
- Ofertat do të dorëzohen vetëm dorazi ose me postë pranë Shërbimit Informativ të Shtetit me adresë Rruga: Kongresi i Manastirit, Tiranë dhe afati i fundit i pranimit do të jetë data 09.12.2010 ora 10:00.
- Hapja e ofertave do të bëhet më datë 09.12.2013 ora 10:00.
- Ofertat e paraqitura pas afatit të fundit të pranimit të sipërcituar, do t’u kthehen të pahapura ofertuesve që i kanë paraqitur ato.